



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: 6.7.2023

Nr: 26

Ora: 17:00

VENDIM

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 3, DATË 06.11.2020, TË KOMISIONIT
RREGULLATOR, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT
DHE ZHVILLIMIT TË SEANCAVE TË KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE",
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja "d", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Fjalja e fundit e pikës 8, të nenit 9, të Rregullores "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve", miratuar me vendimin nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:
 - a) "...Për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme, apo në rastin e përsëritjes së zgjedhjeve, afati i ankimit 3 (ditë), i përcaktuar në pikat 1, 7 dhe 8, të këtij neni, bëhet 24 (njëzet e katër) orë..."
2. Ngarkohet Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO Kryetar

Arens ÇELA Anëtar

Dritan ÇAKA Anëtar

Helga VUKAJ Anëtar

Muharrem ÇAKAJ Anëtar

Data: 6.7.2023 Nr: 26
Ora: 17:00



"Për një ndryshim në vendimin nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e rregullores "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, të ndryshuar"